



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fajtona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 30 maj.
2. Diskutimi në parim, nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh (*Komision për dhënie mendimi*).
3. Diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për muajin qershor.

Marrin pjesë:

Fajtona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa dhe Klajdi Qama, Selami Jehnishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Vilma Bello, Almira Xhembulla.

Të ftuar:

Kostandin Shkurti – Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Elvira Baze - përgjegjëse e Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Sport në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Valbona Shujaku - Zëvendësministre e Kulturës,

Sofjan Jaupaj - drejtor i të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës,

Elira Dani - drejtoreshë e Drejtorisë Rregullatore në Ministrinë e Kulturës,

Artan Syziu - përgjegjës i Sektorit të Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë,

Esmeralda Velaj - specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Deputet propozues:

Adnor Shameti

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Mirëmëngjesi!

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të datës 30 maj 2019.

Keni diskutime apo vërejtje?

Miratohet.

Pika e dytë është shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh, për të cilin ne jemi komision për dhënie mendimi. Nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi të ftuar zotin Kostandin Shkurti, zëvendësministër.

Mirë se erdhët!

Gjithashtu, kemi të ftuar zonjën Elvira Baze, përgjegjëse e sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Sport, Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Mirë se erdhët!

Nga Ministria e Kulturës nuk ka të ftuar prezent.

Nga Ministria e Drejtësisë nuk ka të ftuar prezent.

Nga deputetët propozues është pjesëmarrës zoti Adnor Shameti.

Villojmë me prezantimin në parim të projektligjit.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qenë se projektligji është pjesë e paketës së paraqitur nga një grup deputetësh në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, janë tri dispozita në grupin e ligjeve që janë paraqitur për ndryshim të lidhura me fushën e veprimtarisë së komisionit tuaj të nderuar. Më lejoni që në emër të deputetëve propozues të paraqes pikërisht ndryshimet që ne kemi parashikuar, që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni. Janë tri dispozita që vijnë për ndryshim.

E para, neni 3 i projektligjit që ne ju kemi sjellë përpara, që lidhet me nenin 149 ekzistues të Kodit Penal, dispozitë që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të autorit, megjithëse

në variantin origjinal të paraqitur para deputetëve është e parashikuar si dispozitë e re, në analizë të fundit, edhe pas diskutimeve që kemi pasur në Komisionin e Sigurisë, në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dhe më së shumti në grupin e punës në Komisionin e Ligjeve, nuk do të jetë dispozitë e re, por do të jetë vetëm riformatim dhe në variantin përfundimtar do të gjejnë pasqyrim të gjitha gjetjet që ne kemi propozuar.

Mund t’jua lexoj edhe riformulimin e nenit 149, “Shkelja e të drejtave të autorit”, ku thuhet: “Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht, shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, përdorimi, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime fitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës, kur janë shkelur të drejtat vetjake pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet”. Ky është paragrafi i parë. “Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”.

Jemi munduar që në analizën që kemi bërë në grupin e punës të kenë gjetur zgjidhje edhe çështjet e teknikës legjislative, që deri më tani nuk ishin ezauruar dhe pasqyruar qartë në variantin origjinal. Kjo është për sa i takon nenit të parë, që ka të bëjë me të drejtat e autorit.

Dy nenet e tjera, 274/a dhe 274/b, janë të reja dhe kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e sportit. Neni 274/a ka të bëjë me goditjen e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, ndërsa neni 274/b ka të bëjë me veprime të dhunshme në aktivitete sportive. Pra, objekti dhe subjekti, në të dyja këto dispozita, është i ndryshëm. Këto janë nenet e reja dhe janë pikërisht këto tri nene që ne kemi paraqitur para jush për t’u ndryshuar si domosdoshmëri për ndryshimin e kushteve dhe situatës së sigurisë, mbi të gjitha gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive, si dhe për mbrojtjen e aktiviteteve të posaçme që kanë të bëjnë me drejtues, me sportistë, trajnerë, arbitër, ndërmjetës sportivë, si subjekte të posaçme, që kërkojnë një mbrojtje të posaçme në analizë të fundit në bazë të cenimit të nivelit të sigurisë për këto subjekte të posaçme, të vërejtura herë pas here në aktivitete sportive në Republikën e Shqipërisë.

Në këto kushte, do të kërkoja përfundimisht që, pasi të diskutonit në këtë komision, të vendosnim miratimin, si në parim, edhe nen për nen të këtyre tri dispozitave, sikurse mbetemi të hapur që çdo vërejtje apo sugjerim, duke qenë komisioni relevant, që ka lidhje me dhënien e mendimeve të çmuara për sa më sipër, t’i marrim në shqyrtim dhe t’i vlerësojmë gjatë analizës fundore në Komisionin e Ligjeve, si komision përgjegjës për këtë ligj.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjalën e ka relatori, zoti Fadil Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Shameti, për parashtrimin e ndryshimeve që bëhen në Kodin Penal.

Sikurse foli edhe Adnori, siç janë të parashtruara edhe në relacionet përkatëse, qëllimet dhe risitë që sjell ky projektligj kanë të bëjnë me fusha të ndryshme, duke përfshirë parandalimin e veprave penale të dhunës në shoqëri, ashpërsimin e masave që duhen për parandalimin e këtyre veprave, siç janë ato të dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit, trajnerit, funksionarëve publikë të zgjedhur e kështu me radhë, që adresojnë problematika që kanë ndodhur dhe ndodhin në shoqëri. Kemi parasysh faktin që ligji nr. 7895 është miratuar në vitin 1995 dhe dinamika e ndryshimeve është pasuruar edhe me vepra që kërkojnë adresimet e tyre penale, siç ka parashikuar fushat e veprimit të tij në pikat që janë parashtruar në këtë projektligj.

Ndryshimet kanë të bëjnë edhe me çështjen e së drejtës së autorit, që është një fushë që shprehem edhe ne si komision, që e kemi adresim të drejtpërdrejtë të problematikave të tilla. Ka masa dhe dispozita aktuale në Kodin Penal, por fenomenet e deritanishme e kushtëzojnë të ketë një mbrojtje më të mirë të pronësisë intelektuale dhe të vlerësojnë se masat nuk janë më të mjaftueshme dhe i kanë lënë hapësirë abuzivizmit dhe shkelje të të drejtave të tyre. Kodi Penal, me ndryshimet e paraqitura, parashikon ashpërsimin dhe adresimin e masave penale ndaj këtij fenomeni.

Ndryshimi tjetër, që shtohet në Kodin Penal, ka të bëjë me problemet për prishjen e qetësisë publike, kryesisht nga subjekte tregtare, të cilat nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit, siç janë edhe ndotjet akustike nga fenomenet e ndryshme që kanë të bëjnë me subjektet që ushtrojnë aktivitet, duke cenuar sigurinë dhe qetësinë publike, që kërkojnë pikërisht ndërhyrje të tilla, siç janë parashikuar në ndryshimet që paraqiten.

Një fushë tjetër, për të cilën bëhet ndërhyrje në Kodin Penal, janë problematikat që lidhen me mbajtjen e armëve, sidomos me armët shpërthyese ose me lëndët plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore apo pa lejen përkatëse të organeve kompetente, si dhe veprime që synojnë pengesa për ndalimin me çdo mjet dhe çdo mënyrë të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik hekurudhor, ujqor apo ajror.

Çështje tjetër mjaft e ndjeshme është edhe ajo që u referohet problematikave me sigurinë ushqimore. Për këto është folur shumë edhe nga strukturat dhe agjencitë përkatëse, që drejtojnë fushën e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore për popullin, por janë vënë re edhe problematika për shkelje të dispozitave ekzistuese dhe propozohen sanksione të ashpra për vepra që janë në fushën e kundërvajtjes administrative apo nuk kanë pasur më parë në Kodin Penal një adresim të drejtpërdrejtë, që synojnë të mbrojnë apo të vlerësojnë çështjet e

sigurisë ushqimore. Për këtë janë parashikuar mekanizma ligjorë që e frenojnë, e parandalojnë dhe i ndëshkojnë ata që nuk i përmbahen legjislacionit përkatës në fushën e sigurisë ushqimore.

Kodi Penal dhe grupi i deputetëve që parashtrojnë këto ndryshime, të konsultuar me ekspertët përkatës, paraqesin edhe problematikat që adresojnë shumë saktë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe pasurojnë më tej të gjitha ndërhyrjet ligjore, që parandalojnë dhe forcojnë masat mbrojtëse për mbrojtjen e natyrës, cilësinë e ajrit, të ujit, të tokës, me mbrojtjen e kafshëve, me shëndetin dhe mbrojtjen e natyrës. Besoj se ka një kuadër të plotë, shumë analitik dhe ne, si komision, na takon t'i mbështesim dhe t'i miratojmë, por edhe t'i bëjmë të njohura në publik, sepse ka një fushë jo shumë të efektshme për njohjen e ligjeve nga publiku dhe më pas ai të vetedukohet me vetëpërmbytje për zbatimin e ligjit, dhe Kodi Penal të jetë i ashpër në masat për ndëshkim për ata që e shkelin, siç parashikohet.

Ne, si komision, kemi tri fusha të mirëfillta që kushtëzohen nga nenet 3 dhe 15 të Rregullores dhe projektligjit, që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së autorit, me goditjen e sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv, si dhe me veprimet e dhunshme në aktivitetet sportive. Këto nisma janë argumentuar, janë konsultuar shumë qartë edhe nga grupi përkatës. Ne kemi Fidelin si përfaqësues të grupit, që ka punuar dhe janë bërë konsulta me Federatën Shqiptare, me universitetet e sportit, me kryetarët e bashkive për këtë çështje, sepse dhuna në sport është bërë një shembull shumë i keq dhe një shqetësim shumë prezent. Ndërhyrja me masa të ashpra ndëshkuese dhe parandaluese është bërë shumë saktë në nenet që parashikohen në këtë fushë, sepse kemi shumë raste dhe trauma të tilla, si goditjen e gjyqtarëve, përdorimin e mjeteve të forta, shkatërrimin e aseteve të stadiumeve, futje e tifozëve në fushë dhe gjithçka tjetër. Unë kam edhe përvojat e mia, kur isha kryetar bashkie, për menaxhimin e shumë problemeve të situatës në sporte, ndaj është shumë mirë që Kodi Penal i ashpëron ndëshkimet në këtë fushë.

Unë nuk jam i fushës së drejtpërdrejtë të jurisprudencës, por në tërësinë e vet, Kodi Penal i ka problematikat aktuale dhe bën plotësimin e nevojshëm të të gjitha risive që sillen, por duhet një shpjegim se si ruhet proporcionaliteti i ndëshkimit apo i masave të ashpra në raport me ato që trashëgojmë nga masat e Kodit Penal, me propozimet e reja të dënimeve që futen, po themi është normale, është parë në koherencë ndëshkimi. Mos është më i rëndë ndëshkimi i gjobave ndaj atyre që pinë duhan sesa i atyre që merren me drogë? Është më i ashpër, fjala vjen, ndëshkimi për një aksident që rrezikon jetë njeriu, apo është më i ashpër dënimi që bëhet për të mbrojtur të jetën e kafshëve?

Këtë lloj proporcionaliteti mbase mund ta shpjegojë Adnori apo të tjerët, që janë pjesë e specializuar për një legjislacion të tillë.

Ky ishte komenti im, për aq informacion sa kam marrë nga materialet e paraqitura. I ftoj kolegët e tjerë, që të japin mendime në lidhje me këtë fushë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Nasufi!

Ka diçka për të shtuar, nga deputetët?

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, duke falënderuar zotin Shameti dhe relatorin tonë, Fadilin, dua të them dy fjalë lidhur me atë pjesë të amendimit të Kodit Penal, që ka të bëjë me të drejtën e autorit. Ndërkohë, këtu është prezent edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, që është edhe një nga anëtarët e grupit hartues të ligjit “Për të drejtën e autorit”. Edhe në cilësinë e ish-ministres së Kulturës, bashkëhartuese e këtij ligji, më vjen shumë mirë që erdhi ky moment dhe konfirmoj se në kohën kur kemi hartuar ligjin “Për të drejtën e autorit”, ne, grupi hartues i këtij ligji, kemi pasur synimin për ta forcuar. Në fakt, i gjithë ligji i ri “Për të drejtën e autorit” është një ligj i cili përforcon shumë masat parandaluese, por edhe ato ndëshkuese, që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtës së autorit.

Që atëherë kemi pasur synimin të fusnim edhe ndëshkime penale, por nëse do ta bënim këtë, e kjo ka qenë një ndër dilemat, hyrja në fuqi e ligjit “Për të drejtën e autorit”, një ligj me mbi 180 nene, do të kondicionohej nga ndryshimi që do të duhej të bëhej në Kodi Penal, për shkak të kësaj mase që ne synonim të fusnim në ligj. Duke mos e pasur të menjëhershme këtë mundësi, për vetë kushtet që kërkon ndryshimi dhe amendimi i Kodit Penal, e mbajtëm masën ndëshkimore në nivelin e masave administrative, për t’ia kaluar më tej gjykatës.

Më vjen shumë mirë që erdhi koha që, në këtë frymë, duke e konsideruar të drejtën e autorit si një ndër të drejtat themelore, por edhe si një ndër kushtet që ne kemi pasur edhe në marrëveshjen për Stabilizim-Asociimin, sipas nenit 70 të asaj marrëveshjeje, ligj për të cilin, praktikisht Komisioni European është shprehur pozitivisht në raport-progreset e tij, pra më vjen shumë mirë që plotësohet me këtë ndryshim, duke iu përgjigjur një kërkesë të grupeve të interesit, por sidomos duke iu përgjigjur detyrimit që kemi, qoftë ne si pushtet ligjvënës, qoftë pushteti ekzekutiv, për të mbrojtur një prej kategorive më vulnerabël, që janë autorët dhe krijuesit.

Kështu, përforcimi nëpërmjet masave penale është mëse i mirëpritur nga unë personalisht, por ndërkohë ftoj edhe të gjithë kolegët e komisionit që ta mbështesin.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

E do fjalën ndokush tjetër?

Ismet Beqiraj – Paketa e amendimeve të Kodit Penal, që po bëhet sot, ka ardhur jo vetëm si nevojë e demokratizimit të gjithë jetës ekonomike e shoqërore të vendit, por edhe për shkak të shumë fenomeneve që kanë ndodhur, të cilat kërkojnë masa më shtrënguese demokratike. Do parë në këtë aspekt dhe jo në aspektin tjetër, siç mund të komentohet, se shtrëngimi i masave të Kodit Penal, amendimet e të cilit po bëjmë sot, kanë sens të kundërt. Përkundrazi, sepse, siç e tha edhe kolegja deputete, mbrojtja e të drejtës së autorit, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja ndaj fenomenit të dhunës, por edhe plot fenomeneve të tjera, në finale i shërbejnë më shumë shoqërisë sesa individëve të caktuar, të cilët janë promotorë të këtyre fenomeneve.

Unë nuk do të ndalem gjatë, por gjithsesi fjalën time do ta shpreh edhe në formë pyetjesh, sidomos për nismëtarët e kësaj pakete ligjore.

Jemi fokusuar tek e drejta e autorit vetëm në një fushë të caktuar, në fushën e artit e të kulturës. Po të drejtën e autorit në fushën e studimeve dhe kërkimeve shkencore, si dhe të drejtën e mbartësve të patentave të ndryshme, në shumë sektorë të vendit? Ka fenomene edhe në sektorë të rëndësishëm. Është vjedhur e drejta e autorit, ne po diskutojmë plagjiaturat dhe kompani të caktuara përdorin një studim të një grupi njerëzish, të cilët kanë kontribuar me vite.

Nga ana tjetër, në këtë paketë të amendimeve të Kodit Penal nuk shoh dënime më të forta lidhur me fenomenin e bulizmit, që ndodh nëpër shkolla, i cili, duhet ta pranojmë, është një fenomen shqetësues dhe në rritje.

Një tjetër fenomen që ka rritje dhe prodhon dramë sociale në familjet shqiptare, është edhe dhuna ndaj grave. Nuk e pashë dhe do të ishte e nevojshme të përfshihej.

Mund të përmendim edhe një fenomen tjetër. Është bërë si lajtmotiv gati-gati legjitim bllokimi i akteve dhe nyjeve kryesore të rrugëve në vendin tonë. Rrugët janë një pasuri kombëtare dhe një e drejtë e patjetërsueshme e përdorimit nga cilido. Po ashtu, edhe institucione të ndryshme, sepse e dimë se në këtë tranzicion janë bllokuar shkolla, spitale, qendra shëndetësore, por edhe objekte të tjera, gjë për të cilën kërkojnë masa më shtrënguese.

Nga ana tjetër, te neni i këtij drafti të paraqitur, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe krimet ndaj mjedisit, nuk lexova kund që ndotja e mjedisit konsiderohet si krim ndaj mjedisit, krime për të cilat duhet të ketë edhe pasoja përkatëse. Tri janë elementet bazë që duhen mbrojtur: ajër, ujë dhe tokë, por është një nen këtu, ku uji nuk ekzistua fare, ndërkohë që uji është elementi i parë që ndotet, përveç ajrit.

Unë do t'i sugjeroja relatorit kryesor, i cili paraqet draftin, që të përfshihet si krim mjedisor ndotja nga sektori hidrokarbur dhe minerar, sepse ne jemi një vend që i kemi këto

pasuri, por megjithatë, në aspektin mjedisor këto janë *hotspotet* më të rrezikshme në vendin tonë.

Ne kemi lumenj të vdekur, ne kemi katastrofa detare, që kanë cenuar e cenojnë edhe turizmin bregdetar, prandaj është domosdoshmëri të përfshihen në këtë akt.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Po, zoti Ylli.

Fidel Ylli – Sipas opinionit tim, në kuadrin ligjor të dënimit dhe parandalimit të dhunës në sport, duke shfletuar shumë nga ligjet europiane gjatë kësaj periudhe, kam vënë re se dy ligje na përafrohen: ligji hungarez dhe ligji portugez. Këto ishin dy ligje të përafërta, për të arritur atë qëllim që ne duam.

Kodi Penal i Hungarisë ka disa dispozita të veçanta për sa i përket dhunës në stadione, gjë që do të thotë se çdo person, i cili shfaq një sjellje të dukshme antishoqërore, një sjellje të dhunshme, që synon të nxisë zemërimin apo përcjell alarm te njerëzit e tjerë, kur ky veprim nuk rezulton vepër penale me rrezikshmëri më të madhe, është i dënueshëm si kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet, me punë në shërbim të komunitetit ose me gjobë. Çdo person dënohet me burgim deri në tre vjet, nëse kryen dëme publike gjatë aktivitetit sportiv në bashkëpunim, në mënyrë që të prishë qetësinë publike në aktivitetin sportiv. Dënohet me burgim deri në pesë vjet çdo person që kryen dëme publike:

- a- Në grup, në bashkëpunim, që prish rëndë qetësinë publike.
- b- Në një ngjarje apo eveniment sportiv.

Ndalimi i personit mund të zbatohet edhe si dënim i ndihmës alternative.

Sipas qëllimit të këtij neni, me “sjellje e dhunshme” duhet të nënkuptohet, gjithashtu, çdo veprim agresioni dhe ndikimi të padrejtë, të ushtruar mbi një person nga zbatimi i forcës fizike, nëse nuk rezulton me dënime trupore.

Çdo sjellje e çrregullt, çdo sjellje e rezistencës së dhunshme ose frikësuese nga persona, drejt veprimtarive të personelit të sigurisë për mbajtjen e rendit publik, është e dënueshme si kundërvajtje penale, me burgim deri në dy vjet, me punë në shërbim të komunitetit ose me gjobë.

Çdo person dënohet me burgim deri në tre vjet, për çdo sjellje të kryer në bashkëpunim, ose kur është i armatosur me armë vdekjeprurëse. Ndalimi mund të zbatohet si dënim alternativ.

Këto janë nene të Kodit Penal të Hungarisë, në të cilat parashikohen situata e ngjarje të vështira në lidhje me rastet e dhunës nëpër stadione.

Në projektligjin që po diskutojmë, fatkeqësisht vetëm dy pika të nenit 274 janë parashikuar të shtohen si alternativë e vetme, për të realizuar këto amendime të reja në kod. Për mendimin tim, duhet të shtohen më shumë alternativa në pikat e nenit 274, ku të trajtohet jo vetëm individit për sjelljet e tij, por edhe veprimtaria në grup individësh, në bashkëpunim. Të shtohen edhe alternativat ndaj sanksioneve, përveç dënimit me burg, siç është rasti i punës në shërbim të komunitetit, si shlyerje e dënimit ose me gjobë.

Për sa i përket projektligjit që kemi sot përpara, neni 74, germa ‘a’: “Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv”:

“Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet.”

Mendoj se këtu janë të nevojshme disa sqarime dhe specifikime. Unë e mendoj këtë frazë si dënim për shkak të detyrës. Se kështu thotë këtu.

“Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet.”

Por kur kjo vepër kryhet në mjediset sportive, që është vazhdim, më shumë se një herë, nëse kryet nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

Mendoj se, nëse do ta lëmë kështu siç është, ne mund të dënojmë çdo javë një, dy, tre, pesë lojtarë dhe t’i fusim në burg. Ky neni 274, pika ‘a’ ka nevojë për specifikim. Duhet specifikuar, sepse mund të kemi dhunë edhe ndërmjet lojtarëve, brenda për brenda territorit sportiv: një lojtar mund të godasë tjetrin, një lojtar mund të godasë arbitrin, por edhe arbitri mund të godasë lojtarin brenda në fushë. Atëherë, si duhet të veprojmë? Pra, duhen specifikuar disa problematika të këtij neni, që më duket se ka nevojë për sqarim.

Siç e thashë edhe në fjalën time të shkurtër, qeveria u mbledh dhe në bashkëpunim me Federatën e Futbollit ngriti një tavolinë të rrumbullakët në hotel “Tirana”, ku morën pjesë të gjitha aktorët dhe faktorët e sportit, për të trajtuar dhunën në sport dhe për të bërë një reformë të thellë në sport.

Unë mendoj se ne nuk duhet ta kalojmë kaq kollaj, me dy shtesa neni, por duhet të marrim në shqyrtim edhe ligjin “Pë sportin”, për të vendosur disa rregulla e disa gjopa shumë herë më të mëdha, që nuk kanë lidhje me Kodin Penal. Në fund të fundit, çështjet e dhunës në sport i ka zgjidhur Kryeministri Rama me vendimin numër 853, datë 7. 12. 2016, miratimin në parim të Konventës së Këshillit të Europës, për një qasje të integruar për rendin, sigurinë dhe shërbimin në ndeshjet e futbollit e të aktiviteteve të tjera sportive.

Po ta lexojmë me vëmendje këtë konventë, ajo është udhërrëfyshi i të gjitha vendeve europiane, në lidhje me qasjet kundër dhunës. Sepse dhuna nuk është vetëm në stadium, brenda në fushë. Dhuna duhet parandaluar që përpara futjes brenda në stadium të tifozëve. Ka një sërë problematikash, të cilat nuk mund të zgjidhen pa një bashkëpunim institucional të Policisë së Shtetit. Se është kuptuar gabim nga Policia e Shtetit: “Ne nuk kemi punë në stadium, sepse s’kemi të drejtë të futemi në fushë”.

Nuk keni të drejtë të futeni në fushë, se në asnjë vend europian, UEFA nuk e lejon Policinë e Shtetit të futet në fushë, por Policia e Shtetit dhe të gjitha agjencitë ligjzbatuese kanë të drejtë të bashkëpunojnë për të evidentuar të gjithë njerëzit problematikë, ndërsa Federata e Futbollit i detyron klubet, që ato t’i anëtarësojnë tifozët nëpër shoqata të ndryshme, për t’i pasur në listën e Policisë së Shtetit e për t’i parandaluar.

Pra, dhuna është një fenomen që nuk zgjidhet thjesht me një nen: “u fute në fushë, të dënoj me tre vjet burg”, se qëllimi i qeverisë nuk është të mbushë burgjet me të rinj e me tifozë, për arsye të ndryshme, për një faj njerëzor të arbitrit ose për shkak të nxitjes së disa tifozëve të dhunshëm.

Unë mendoj se Konventa Europiane duhet parë nen për nen, në mënyrë të integruar, se si parandalohet dhuna, që të mos arrijmë deri këtu. Unë nuk jam kundër këtyre neneve, por kërkoj një sqarim të nenit nr. 274, pika ‘a’, sepse do të mbetet në dorë të gjyqtarit, i cili mund të fusë kë të dojë në burg, po nuk e specifikuam nëse quhet dhunë goditja e një lojtari ndaj një lojtari tjetër, goditja e arbitrit ndaj lojtarit, goditja e lojtarit ndaj arbitrit, të cilët ndodhen brenda territorit të fushës. Se është shumë e thjeshtë për ta dënuar një njeri që vjen nga tribuna dhe futet në fushë.

Unë mendoj se kjo kërkon një shpjegim. Në lidhje me rastin e një grupi tifozësh, që bashkëpunojnë për të krijuar *alert* në stadium e për të nxitur urrejtje e dhunë, unë mendoj se duhet të sanksionojmë një nen të veçantë, që të rritet dënimi maksimal, siç e ka parashikuar edhe Kodi Penal i Hungarisë, që nxitja në grup, në bashkëpunim, dënohet deri në 5 vjet.

Ne vërtet jemi një komision që japim mendim, por unë do të doja që ky Kod Penal, i cili pëson ndryshime kaq të mëdha, duhet të kishte pasur një debat më të madh publik me grupet e interesit, me federata, me shoqata, me tifozë, me njerëz të ndryshëm, sepse kemi të bëjmë me jetë njerëzish, kemi të bëjmë me imazhin e Shqipërisë, si dhe me shumë problematika të tjera, kështu që nuk mund ta kalojë thjesht një grup pune, meqë ka lënë qeveria një afat, dhe o burra ta kalojmë shpejt e shpejt.

Ne edhe mund ta shtynim pak më shumë, por thjesht duhet të mos ndërhyjmë çdo vit në Kodin Penal apo në ligjin “Për Sportin”, për të bërë ndryshime, por duhet të mendohemi

mirë. Kur zhvillohen debate publike me njerëz që kanë interes, shoqata, klube, federata, prindër e sportistë, unë mendoj se ligji bëhet shumë herë më i mirë sesa ky që ka sjellë grupi i deputetëve, duke bërë thjesht dy ndryshime shumë të vogla.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Ylli!

Fjalën e ka zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Po e marr sërish fjalën. Duke reflektuar e duke rilexuar, nisur edhe nga kërkesat e grupeve të interesit, që kanë të bëjnë prapë me të drejtat e autorit, lidhur me përdorimin e veprave online, propozoj që te neni 3, pas togfjalëshit “mbajtësit e së drejtës”, pra: “shpërndarja, komunikimi publik, shitja, ofrimi për shitje” e të tjera, “pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës”, të shtohet edhe ky amendim: “në të gjitha format, mediumet, si dhe në internet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Te diskutimet nen për nen.

Mirela Kumbaro – Në rregull! Po përfitoj nga rasti që kam mikrofonin, për t’i bërë ndoshta një plotësim pyetjes së kolegut që kam në krah, zotit Ismet. Për sa u përket figurave që ju përmendët lidhur me të drejtën e autorit, janë të gjitha figura të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e autorit”. Kështu që kur flasim për ndëshkim në rastin shkeljes së këtyre të drejtave, janë të gjitha ato që janë parashikuar në ligj.

Për sa u përket patentave, ato janë në një kategori të veçantë, te pronësia intelektuale, ku Kodi Penal e ka të parashikuar ndëshkimin me burg për shkeljet e të drejtës së pronësisë intelektuale industriale ose ndryshe të patentave. Kështu që besoj se ky problem është i zgjidhur qoftë për rastin e parë, ashtu edhe për të dytin.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit diçka për të shtuar dhe diskutuar lidhur me prezantimin e shtesave?

Kostandin Shkurti – Ministria e Arsimit në opinionin e saj bashkohet me të gjithë masat ndëshkimore që janë marrë deri tani, sidomos për nenet 274 dhe 274\A, pasi në fushat dhe mjediset sportive dhuna ka qenë prezente shpeshherë dhe në një nivel shumë më të ashpër dhe të padëshiruar për sportdashësit tanë. Unë mendoj që duhet marrë në konsideratë propozimi që bëri zoti Ylli. Mendoj që këto dy nene të kenë një hapësirë tjetër dhe jo të jenë të segmentuara. Për shembull, te neni 274\A thuhet: “Kur vepra kryhet në ambiente sportive nga persona që janë pjesë e veprimtarisë sportive, dënohet me burgim deri në 5 vjet”. Unë mendoj

që ndëshkueshmëria të jetë 3-5 vjet, sepse ne e dimë si zbatohet ligji dhe si ndëshkohen njerëzit në këto nivele. Nuk bashkohem kurrë me dhunën e shkaktuar në ndeshjen Kastrioti-Laçi, ku një nga presidentët u fut në fushë dhe goditi arbitrin. Këto raste nuk janë të vetmet. Unë bashkohem me shqetësimet që solli zoti Nasufi, i cili ka qenë kryetar i bashkisë së Beratit dhe është hasur me këto probleme. Një nga eksperiencat e mia, kur kam qenë drejtues i një institucioni, ka qenë kur tifozët anglezë nuk hynin në hotel, sepse kishin frikë nga policia shqiptare se mund t'i evidentonte dhe dënoheshin deri në 7 vjet burg. Pra, unë theksoj se në këtë fazë që jemi, ligji duhet të jetë më i ashpër, sepse, siç e tha edhe parafolësi, nuk është një element kalimtar, por është element demokratik, i cili, ashtu siç është parashikuar në ligjin e sportit, përveç masave që ka me gjobë dhe kundërvajtje, duhet të ekuilibrohet edhe me këto nene kaq të forta.

Gjithashtu, edhe për nenin 274/a, kur është me dashje, unë nuk jam dakord të lihet me burgim deri në 5 vjet, por të jetë 5 vjet. Këto janë propozimet që ne mendojmë se duhen marrë në konsideratë nga grupi që ka hartuar ligjin.

Ju kërkoj falje, sepse ne nuk kemi qenë në grupin e ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, pasi e ka drejtuar Ministria e Brendshme bashkë me Ministrinë e Drejtësisë. Pra, unë them që masat duhet të jenë më të ashpra dhe më të forta në këtë situatë kaq të vështirë që ndodhen mjediset sportive. Dhuna është shfaqur në momente të ndryshme në stadiumet sportive, e cila ka ndodhur midis sportistëve dhe, nga eksperiencia kaq e gjatë që kemi parë në fusha, stadione dhe pallate sportesh, përleshjet nuk janë dënuar kurrë me burgim, por me masa administrative ose me gjobë. Prandaj mendoj se problemet midis sportistëve nuk duhet të jenë me dënim me burg.

Për sa i përket dhunës, unë mendoj se këto masa duhet të jenë më radikale dhe më të forta.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

A kanë diçka për të shtuar përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës?

Valbona Shujaku –Përshëndetje!

Më falni për vonesën, por kishte një ngatërresë me orarin!

Duke iu referuar ligjit “Për të drejtën e autorit”, ky projektligj synon të përfaqësojë dhe të përditësojë ndryshimet e vazhdueshme të ndodhura në fushën e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, t’u përgjigjet zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit, të korrigjojë dhe të përmirësojë vakuumet ligjore dhe t’u vijë në ndihmë krijuesve të të gjitha fushave. Ky projektligj ka për synim përmirësimin e sigurisë për aplikimin e të drejtave në

fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, duke pasur si objektiv nxitjen e krijimtarisë së kësaj fushe.

Gjithashtu, synimi i këtij projektligji është të sigurojë zgjidhjen e problematikës së shpërblimit të titullarëve të pronësisë intelektuale dhe rritjen e shlyerjes në shkallë më të lartë të detyrimeve ndaj titullarëve të pronësisë intelektuale, duke forcuar penalizimin, shumëformalizimin dhe shpërblimin për krijuesit. Efektet e pritura nga ky projektligj lidhen ngushtë me të drejtat morale dhe ekonomike të autorit, duke përfshirë dispozita ligjore e penale, të cilat lidhen me përdorimin e veprës në mënyrë masive me autorizimin përkatës nga titullari i së drejtës. Pritet që përdorimi i veprave, sipas parashikimeve ligjore, të rritet ndjeshëm dhe për rrjedhojë të rritet edhe shpërblimi i autorëve përkatës.

Ndërgjegjësimi dhe lufta ndaj shkeljeve të së drejtës së autorit vazhdon të mbetet prioritet i rëndësishëm, pasi, përveç sensibilizimit të projekteve përdoruese, Republika e Shqipërisë, ashtu si edhe shtetet e huaja, ndeshet me zhvillimin e teknologjive të reja e të shpejta.

Risitë teknologjike nxjerrin në pah faktin se dispozitat ligjore parashikuese janë thuajse gjithmonë një hap mbrapa formave të ndryshme të reja të cenimeve që burojnë si rezultat i teknologjisë.

Me amendimin e Kodit Penal të propozuar, pritet të ketë përparësi më të theksuar në zbatimin e ligjit. Kjo masë ligjore vjen si rezultat i miratimit të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, duke e përafruar me 9 direktiva të Parlamentit Europian dhe Këshillit. Për pasojë, synohet që kjo fushë të përditësohet edhe në fushën penale.

Aktualisht, janë bërë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, duke hequr nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale “i dëmtuari akuzues”, nga neni 148 “botimi i veprës së tjetrit në emrin e vet”, nga neni 149 i Kodit Penal “riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, të cilat kanë kaluar te neni 284 i Kodit të Procedurës Penale, “Ankimimi”. Këto ndryshime janë aplikuar me qëllim që veprat penale të pronësisë intelektuale, nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal, të ndiqen me ankim, në mënyrë që detyrimet për të hetuar dhe provuar akuzat t’i ketë jo i detyruari akuzues, por organi procedues, që është prokuroria.

Sot gjykohet e domosdoshme nevoja për të pasur një mbrojtje më të madhe të parashikuar në Kodin Penal, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorit. Propozohet që pas nenit 148, të shtohet neni 148/a me titull “Shkelja e të drejtave të autorit” me këtë përmbajtje: “Shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtpërdrejta, përfitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit e të drejtës, përbën kundërvajtje penale dhe

dënohet me gjobe ose me burgim deri në dy vjet”. Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në tri vjet.

Përmes këtyre amendimeve do të përmbushen afatet e përcaktuara në PKIE 2017-2020 për kapitullin VII “Të drejtat e pronësisë intelektuale”.

Gjithashtu, jemi dakord me amendimin e propozuar nga zonja Kumbaro për sa u përket veprave *online*.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A kanë diçka për të shtuar përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë?

Ne prezantojmë disa nisma, ku një grup deputetësh sjellin një iniciativë, por ndërkohë ne kërkojmë të ashpërsojmë dënimet e Kodit Penal, pa përcaktuar një kuadër tjetër ligjor ose, më mire, pa ndërtuar infrastrukturën ligjore të stadiumeve tona. Ne po forcojmë masat në Kodin Penal, duke ditur që stadiumet apo klubet sportive në Republikën e Shqipërisë janë copë-copë. Atëherë, unë dua të bëjë një pyetje. A është marrë parasysh nga qeveria që ndërmerr një nismë të tillë, kur stadiumet tona janë pa standarde dhe përpara se të rregullojmë infrastrukturën e stadiumeve, të rregullojmë një kuadër tjetër ligjor?

Së dyti, për një iniciativë të tillë ligjore, e cila parashikon masa ndëshkimore në Kodin Penal, a janë pyetur grupet e interesit, si: sportistët, trajnerët, arbitrat dhe ndërmjetësit sportivë? Pra, përpara se të marrim iniciativa të tilla, duhet të parashikojmë rregullimin, infrastrukturën dhe standardet e stadiumeve tona, ndërkohë që qeveria dhe Kryeministri e dinë shumë mirë se si është gjendja e stadiumeve në Republikën e Shqipërisë.

Milva Ekonomi- Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, për sa i përket diskutimit lidhur me standardet në stadiumet tona, besoj se të gjithë ne jemi dëshmitarë se përpjekja e qeverisë është që sporti të kthehet në një të mirë publike, ku, përveçse është investuar shumë në stadiume, ku jemi dëshmitarë të stadiumeve të reja të ndërtuara në këtë periudhë 6-vjeçare, kemi edhe diçka të re në sistemin tonë arsimor, që shkolla është kthyer në qendër komuniteti, ku shumë nxënës ushtrojnë sportet në ambientet e duhura. Kështu që, infrastruktura sportive është përmirësuar jo vetëm në stadiume, por edhe nëpër shkolla. Prandaj, mendoj se me këto ndryshime të ardhura, nuk kërkohet vetëm përmirësimi i infrastrukturës sportive, e cila ka ndodhur, dhe qetësia në sport, por kërkojmë të krijojmë një model të tifozit, i cili duhet të jetë konform eksperiencave ndërkombëtare dhe atyre europiane, siç tha zoti Ylli.

Së dyti, lidhur me pyetjen nëse janë pyetur grupet e interesit për ndryshimet në Kodin Penal, besoj se të gjitha gjërat kanë ndodhur në sy të publikut, sepse takimet kanë qenë

mediatike. Takimet me grupet e interesit kanë filluar në hotel “Tirana”, ku ishin të ftuar federatat e sportit, përfaqësuesit e sportit, ndërmjetësit sportivë, ne, deputetët, qeveria dhe të tjerë të interesuar, siç janë financuesit e sportit, ku janë bërë diskutime të vazhdueshme për këtë çështje. Unë mendoj se ajo që ka sjellë këtu grupi nismëtar nuk është vetëm raporti përfundimtar i këtij grupi, por edhe diskutimet që janë bërë me grupet e interesit. A ka nevojë për diskutim?! Unë besoj se në diskutimin nen për nen secili nga ne mund të hyjë me propozime të caktuara, ku zoti Ylli, zoti Shkurti dhe zonja Kumbaro dhanë disa propozime.

Para se të kalojmë në diskutimin në parim, unë mendoj që nismëtarët të na sqarojnë pak më gjatë për këtë situatë, pra që projektligji që ne kemi sot, nuk është projektligj i padiskutuar më parë.

Lidhur me sportin, jo vetëm që kemi pasur investime, por e kemi menduar edhe si një element të rëndësishëm të shëndetit të mirë për gjeneratën që po vjen.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Ne nuk mund të flasim vetëm për 2 apo 3 stadione, pasi Shqipëria ka shumë dhe ne e dimë mirë gjendjen e tyre.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Hapet votimi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Ismet Beqiraj – Së pari, relatori duhet të na japë shpjegime, sepse ne bëmë pyetje, dhamë mendime dhe propozime.

Së dyti, propozova që te nenet, të cilat kanë të bëjnë me masa më të ashpra për mjedisin, të shtohen fjalët “për mbrojtjen e ujërave”, ku ndodhin katastrofa ekologjike detare, të cilat shkatërrojnë imazhin e turizmit të Shqipërisë, shkarkojnë cisternat, shkarkojnë në përrënje e lumenj kompanitë hidrokarbure. Prandaj, unë kërkoj shpjegim nga relatori, i cili është nismëtar bashkë me një grup deputetësh.

Fatjona Dhimitri – Fjalën e ka zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të pare, më lejoni të falënderoj gjetjet dhe konstatimet e relatorit, të zotit Nasufi, dhe zotit Ylli, në cilësinë e anëtarit të këtij komisioni!

Para se të kalojmë në votimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji, dua të sqaroj diçka.

Për sa u takon sugjerimeve dhe gjetjeve të zotit Ismet lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit, pavarësisht se nuk janë pjesë e ekspertizës dhe veprimtarisë së këtij komisioni, më lejoni t'ju siguroj se të gjitha shqetësimet tuaja kanë gjetur dhe do të gjejnë zgjidhje në diskutimin nen për nen dhe në analizën përfundimtare që do t'u bëhet dispozitave, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, përfshirë edhe ujërat, të cilat do t'i analizojmë një për një në Komisionin e Ligjeve.

Nga ana tjetër, në lidhje me sugjerimet e zotit Ylli, duke e falënderuar edhe për punën kërkimore që kishte bërë me ligjet relevante në Bashkimin Europian, të cilat kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e veprimtarive sportive dhe me subjekte të posaçme pjesëmarrësish në veprimtaritë sportive, dua t'ju them se në relacionin përfundimtar të këtij komisioni të nderuar të gjejnë pasqyrim të gjitha këto sugjerime dhe ne do t'i bëjmë pjesë të integruar të të gjitha diskutimeve në Komisionin e Ligjeve. Ju siguroj që do t'i shikojmë me vëmendjen maksimale këto tri dispozita, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këtij komisioni të nderuar.

Drafti përfundimtar i relacionit, që do t'i përcillet Komisionit të Ligjeve për dhënie mendimi nga ana e këtij komisioni, do të jetë i pasqyruar në detaje. Ju siguroj se të gjitha do të gjejnë zbatim dhe do të diskutohen me përgjegjësinë më të madhe nga ana e kolegëve të Komisionit të Ligjeve, me qëllim që varianti përfundimtar të jetë ai i duhuri për shoqërinë, për subjektet e posaçme dhe për gjithçka tjetër.

Dua të bëj një parantezë para se të mbyll fjalën time dhe t'ua kaloj fjalën për diskutimet nen për nen. Megjithatë, unë e pashë që pyetjet dhe diskutimet që u bënë nga kolegët e nderuar të këtij komisioni, ishin jo vetëm për pjesën e diskutimit në parim, por edhe për analizën dhe diskutimin nen për nen. Gjithsesi, jam i hapur të dëgjoj sugjerimet tuaja për analizën e këtyre dispozitave.

Dua t'ju siguroj që kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal vjen pas një pune dhe pas një konsultimi të gjerë publik me aktorët dhe faktorët e interesuar dhe kemi qenë shumë të përgjegjshëm për adresimin e të gjitha grupeve të interesit, për përfshirjen e tyre në të gjitha diskutimet që kemi bërë. Kështu që të jeni të sigurt se është varianti më i mirë i dakordësuar, i analizuar dhe i sqaruar me të gjitha grupet e interesit.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Faleminderit!

Neni 1. A keni ndonjë gjë për të shtuar? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3.

Urdhëroni!

Mirela Kumbaro – Propozoj që në nenin 3, te paragrafi “Shpërndarja, komunikimi publik, shitja, ofrimi për shitjen, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtpërdrejta, përfitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit pa pëlqimin e autorit ose e mbajtësit të së drejtës”, pas togfjalëshit “mbajtësit të së drejtës” të shtohet “në të gjitha format, mediumet, si edhe në internet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet”.

Fajtona Dhimitri – Urdhëroni!

Milva Ekonomi – Përveç zonjës Kumbaro, edhe ju kishit bërë një ndryshim në nen. Atëherë, a mund ta riformulojë nenin komplet Ministra e Kulturës dhe të na e sjellë në komision? Përveç zonjës Kumbaro, edhe ju, kur e lexuat, bëtë një ndryshim. A mund ta kemi nenin e plotë të formuluar nga ju?

Fajtona Dhimitri – Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Pse të mos bëhet një nen integral, ku të përfshijë në një paragraf edhe pronësinë industriale, ku të përfshihet edhe e drejta e autorit në fushën e kërkimit shkencor?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e konceptoj dhe e propozoj kështu, më pas ta shikojnë juristët, por të përfshihet e drejta e pronësisë industriale në fushën e kërkimit shkencor.

Fajtona Dhimitri – Nga Ministria e Kulturës?

Sofjan Jaupaj – Propozimi i zonjës Kumbaro, në fakt, është edhe propozimi që Ministria e Kulturës ka përcjellë pranë Komisionit të Medies, në zbatim edhe të konsultimit publik me grupet e interesit, me autorët, si edhe agjencitë e administrimit kolektiv. Nuk jemi dakord me propozimet për përfshirjen e pronësisë industriale dhe të plagjiaturës, përveç faktit kur pronësia industriale parashikohet në një ligj të veçantë. Gjithashtu, është parashikuar në Kodin Penal në nenin 149/a “Shkelja e të drejtës së pronësisë industriale” i njëjti parashikim, siç po e sjellim, për të drejtën e autorit.

Ndërkohë, në lidhje me riprodhimin pa të drejtë të veprës së tjetrit. plagjiatura, është e parashikuar në Kodin Penal, që është neni 149 “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, si edhe në nenin 148 “Botimi i veprës së tjetrit me emrin e tij”. Pra, janë të parashikuara në Kodin Penal këto parashikime të propozuara. Kështu që ne sugjerojmë të përfshihet vetëm parashikimi i propozuar nga zonja Kumbaro, si edhe nga Ministria e Kulturës, që pas togfjalëshit “mbajtësit të së drejtës” të shtohet togfjalëshi “në të gjitha format, mediumet, si dhe në internet”. Neni total

do të ishte: “Shkelja e së drejtës, shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi eksportimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtpërdrejta, përfitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit e së drejtës në të gjitha format, mediumet, si dhe në internet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose më burgim deri në vjet 3”.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Urdhëroni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Meqenëse ju e doni të ndarë të drejtën e autorit nga pronësia intelektuale dhe industriale, edhe unë do të propozoja që të shtohet dhe të bëhen ndryshime te neni që ju më cituat, duke u ashpërsuar, sepse në Shqipëri ndodhin absurditete. Unë nuk kam ndërmend ta denoncoj këtu hapur se çfarë është bërë me projekte të mëdha në fushën e kërkimit të naftës dhe të çmimit, pra është vjedhur. Nuk është një plagjiaturë, pra që ka marrë një pasazh në hyrje, por ka marrë të gjithë studimin.

Fajtona Dhimitri - Faleminderit!

E hedhim në votë propozimin e zonjës Kumbaro.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votë propozimin e zotit Beqiraj. Pro?

Mirela Kumbaro – Në qoftë se vjen i formuluar, pra zoti Ismet të na e formulojë saktë se cili nen është dhe si ndryshohet, që të mos e propozojmë thjesht në parim.

Ismet Beqiraj – Jam dakord, sepse kisha menduar që këtu të shtohet si paragraf, prandaj bëra sugjerim. Nuk ka asnjë problem. Unë ia çoj amendimin komisionit përgjegjës, në mënyrë që të mos e fusim në një kolaps të teknikës juridike.

Fajtona Dhimitri - Faleminderit!

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5 “Ndotja e ajrit dhe e tokës”.

Urdhëroni, zoti Beqiraj!

(Deputeti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon.)

Fajtona Dhimitri – Më falni, zoti Beqiraj. Nuk mund të largohet njeri, as deputetët propozues, as edhe paneli i të ftuarve për momentin. Ju lutem, jemi duke votuar propozimin!

Mund të vazhdoni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Këtë e propozoj për faktin se futja e lëndëve radioaktive, kimikateve tepër të rrezikshme në tokë... Toka është me lagështirë, me ujë, pra uji është elementi i parë që toksifikohet, kontaminohet, ndaj duhet përfshirë detyrimisht. Atje ku është togfjalëshi “ndotja e ajrit dhe e tokës” të futet edhe “uji”, pra të bëhet “ndotja e ajrit, ujit dhe e tokës”. Këto janë 3 elemente.

Fajtona Dhimitri – Faleminderit!

Zoti Shameti, cili është qëndrimi juaj lidhur me propozimin e zotit Beqiraj?

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë mendoj që në variantin e paraqitur nga ne, gjejnë pasqyrim të gjitha këto gjëra. Kështu që gjithçka, që ju mund ta përfshini në relacionin tuaj, do ta shqyrtojmë me përgjegjësi në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – E hedhim në votim propozimin zotit Beqiraj.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 5 bashkë me ndryshimin e zotit Beqiraj.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15.

Urdhëroni!

Fidel Ylli – Neni 15 “Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit”. Dua një përkufizim nga Adnori, më pas të bëjmë një ndryshim që ta specifikojmë mirë nenin, sepse është shumë abuziv, kështu siç është .

Adnor, ndoshta në pikën 1 duhet: “Goditja ose vepra të tjera dhune...”

Fajtona Dhimitri – Si mendoni ju, zoti Shameti, lidhur me propozimin e zotit Ylli?

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

E mirëkuptoj ndërhyrjen e zotit Ylli dhe dua të sqaroj që subjekti i posaçëm nuk është sportisti në këtë dispozitë. Megjithatë, janë çështje që i takojnë teknikës legjislative dhe nuk ka asnjë ambiguitet, pra nuk është sportisti vetë subjekti i posaçëm, ai ka përgjegjësi disiplinore sipas Kodit të Etikës dhe rregullave për ligjin “Për Sportin”. Subjekt i posaçëm janë drejtuesit e klubeve sportive, pra kjo është e qartë. Kështu që mos kini asnjë shqetësim.

Gjithsesi, çfarë ju mendoni më të udhës apo që duhet sqaruar më mirë, qoftë për teknikë legjislative, qoftë për shtesë në dispozitë, jeni të mirëpritur ta bëni, që të jetë pjesë e integruar e relacionit tuaj përfundimtar.

Fidel Ylli – Së pari, këtu është e shkruar qartë, zoti Adnor: “Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit (është e para), ndaj trajnerit, ndaj arbitrit dhe ndaj ndërmjetësit sportiv”, pra kjo është e shkruar këtu, nuk lëviz dot. Në qoftë se ne do ta lëmë kështu, nesër do të gjendemi para faktit që mund të dënojmë çdo javë nga një ose nga dy sportistë; duhet përcaktuar jashtë fushës. Pra, në momentin e parë duhet të themi “për shkak të detyrës”, por jashtë fushës dhe duhet të ndajmë pjesën e fushës. Duhet ta zgjidhim këtë çështje, se është e paqartë.

Së dyti, unë mendoj se duhet të shtojmë diçka te ky nen: “Sjellja e dukshme antisportive, e dhunshme që synon të nxisë panik, alarm, zemërim te pjesëmarrësit, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me punë në shërbim të komunitetit ,ose me burg deri në 3 vjet”. Pra, jo vetëm thjesht çështjen e fushës, por ka njerëz që nxisin dhunë në fushë, në tribunë. Kjo vepër, kur kryhet në grup, është dënim më i rëndë, cenon zhvillimin normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

Fajtona Dhimitri – A keni gjë tjetër për të shtuar?

Adnor Shameti – Edhe një herë e mirëkuptoj dhe e vlerësoj ndërhyrjen e zotit Ylli dhe, nëse do të kishit një version përfundimtar, kalojeni këtu atë variant që ju propozoni dhe do ta shikojmë me përgjegjësi të plotë në analizën përfundimtare, në miratimin nen për nen në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – E hedhim në votë propozimin e zotit Ylli.

Kush është dakord me propozimin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Urdhëroni!

Milva Ekonomi – Dua të theksoj për procedurë që propozimi i zotit Ylli do të bëhet pjesë integrale e relacionit, që do të përgatisë komisioni ynë për Komisionin e Ligjeve. Kështu që edhe këtë gjë duhet ta kemi parasysht.

Fajtona Dhimitri – Po.

Neni 15. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. A ka ndonjë propozim? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë në tërësi projektligjin.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, zoti Shameti, mund të largoheni!

Adnor Shameti – Duke ju falënderuar ju, zonja kryetare, dhe kolegët e nderuar të këtij komisioni, në diskutimet nen për nen që do të kemi në Komisionin e Ligjeve, ju siguroj se sugjerimet tuaja shumë të vlefshme do të gjejnë pasqyrim, si pjesë e ekspertizës më të mirë për dispozitat që trajtuam në këtë komision, për të bërë variantin më të mirë të mundshëm.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të gjitha propozimet për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” do t’ia paraqesë Komisionit të Ligjeve së bashku me relacionin përkatës.

Relatori dhe propozuesit, ju lutem, të qëndrojnë në sallë!

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Milva Ekonomi - Zonja kryetare, a mund të shtoj diçka për procedurë? Në raportin që çojmë te Komisioni i Ligjeve, duhet të shtojmë këto 3 gjëra: propozimin e zonjës Kumbaro, që duhet ta formulojmë menjëherë tani, propozimin e zotit Beqiraj dhe, zoti Ylli, të gjitha gjërat që do të propozosh, të shkruhen tani. Duhet të jemi të shpejtë, sepse mbledhja e atij komisioni fillon në orën 11:00.

Fajtona Dhimitri – Në rregull, të ulet Gazi me Ismetin dhe me Fidelin, që t’i shkruajnë të gjitha propozimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fajtona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për muajin qershor.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa dhe Klajdi Qama, Selami Jehnishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Vilma Bello, Almira Xhembulla.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Ju lutem, ne kemi një draftkalendar që e ka përgatitur Muhameti, kështu që ta falënderojmë edhe Muhametin, edhe Gazin, edhe Arianën, që na kanë ndjekur këto ditë nga afër.

Nuk e di a ka ardhur përgjigjja nga Këshilli i Ministrave për projektligjin “Për akademinë”.

Fatjona Dhimitri – Në datën 11 qershor (*i referohet projektkalendarit*) është parashikuar shqyrtimi i korrespondencës së ardhur në komision, kërkesa e Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri.

Milva Ekonomi – Kërkesa e CRCA-së lidhet me projektligjin “Për rininë”. Unë mendoj që nuk kemi pse ta thërrasim CRCA-në tani, por ta thërrasim kur të bëjmë gati kalendarin për këtë projektligj. Ndërkohë, nuk ka datë të përcaktuar në kalendarin e Kuvendit. Pra, ne të njihemi me projektligjin dhe të japim një afat për të diskutuar, por duhet të kemi parasysh se zgjedhjet janë me 30 qershor, prandaj jemi të detyruar të bëjmë disa gjëra që janë të lidhura me aktivitetin e komisionit, nesër ose pasnesër.

Zakonisht të premtet ne i kemi lënë të jemi në zonat elektorale, pavarësisht nga krahu politik. Të hënën kanë qenë mbledhjet e grupit të PS-së dhe është rënë dakord që mbledhja e komisionit të fillojë në orën 11.00. Edhe kur PD-ja ka pasur mbledhje grupi një ditë tjetër të javës, ka qenë gjithmonë e mirëpritur për të rivendosur oraret.

Kështu kemi punuar, duke respektuar oraret e punës së partive.

Fatjona Dhimitri – A ka ardhur shkresa për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”?

Nuk ka ardhur akoma.

Mirë është t’u kthehet përgjigje zyrtare atyre që dërgojnë letra, qoftë AMA-s, CRCA-së e cilitdo tjetër.

Lidhur me Akademinë e Shkencave theksoj se është një çështje me rëndësi kombëtare, që na cenon dhe na prek të gjithëve.

Sa i takon personave që do të thirren në dëgjese, sipas kalendarit të parashikuar kemi seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”.

Ne i thirrëm këtu akademikët, edhe zotin Gjinushi që është kryetar i sapozgjedhur. Unë kërkoj që ai të thirret në një seancë më vete, por nuk e di se sa ju do të ma miratoni këtë kërkesë.

Kërkoj të thirret më vetë në një seancë zoti Fuga, jo së bashku me akademikët e tjerë.

Milva Ekonomi – Zotit Fuga ia kemi parashtruar kërkesën, nëse zoti Fuga është akademik me titull, dhe i kemi bërë një letër Akademisë së Shkencave, ku i themi të vijnë të gjithë akademikët, duke përfshirë edhe zotin Fuga, i cili ka të drejtën e padiskutueshme të vijë kur është e ftuar Akademia e Shkencave.

Zoti Fuga mendon se nuk është e përshtatshme të vijë kur vijnë gjithë akademikët e tjerë dhe meqenëse zoti Fuga është kaq shumë problematik, kaq shumë opinionbërës, kaq

shumë mendimtar, ka kaq shumë ide për të gjitha këto që mendon opinioni, i dhamë dy opsione: ose hajde me Akademinë, ose hajde më vete.

Në fillim zoti Fuga tha se do vinte me Akademinë, pastaj tha se donte të vinte vetëm dhe ne i thamë “dakord” në të dyja rastet. Kështu që zoti Fuga nuk mund ta diskutojë më këtë gjë, pasi çfarë ka dashur zoti Fuga, ka bërë komisioni!

Fatjona Dhimitri – Dakord! Unë e propozoj vetë që të vijë në një seancë më vete.

Milva Ekonomi – Nuk ke si ta propozosh, sepse është propozuar. Është marrë vendimi. Nuk ka çfarë të propozohet më. Vendimi është marrë që zoti Fuga do të vijë më vete. Ajo që mund të bëni ju është ta njoftoni, se s’kemi çfarë vendimi të marrim. E kemi marrë vendimin, pasi e dëgjuam për të gjitha shqetësimet që ai kishte.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, seancë dëgjimore me rektorët e universiteteve.

Milva Ekonomi – Duhet të sqarojmë disa gjëra.

E para, projektligji nisi si nismë deputetësh, kështu që deputetët kanë të drejtën të vijnë ta parashtrojnë dhe të thërrasin kë të duan. Edhe ne në komision kemi të drejtë të thërrasim kë të duam. Ne thirrëm grupin e punës dhe teknikun e huaj, asistencën teknike, që kishte ndihmuar Akademinë.

E dyta, bëme një kalendar pune, i cili ndahej në thirrjen e Akademisë së Shkencave dhe Akademisë së Albanologjisë, thirrjen e të gjithë rektorëve, thirrjen e akademikëve të pavarur, ku futëm zotin Fuga dhe zotin Haxhimihali. Në fund thamë se, nëse do të ketë ndonjë interes të shtuar nga të tjerë, siç është, për shembull, Aurela Anastasi, që ka sjellë propozime në komision, mund të vijnë edhe të tjerët që kanë dëshirë për të folur, ose edhe universitetet private që kanë shprehur dëshirën për të folur.

Për të gjitha këto është rënë dakord, prandaj nga ana juaj duhet të bëhet vetëm njoftimi, se këtë vendim e kemi marrë.

Fatjona Dhimitri – Dakord, Milva. Unë thjesht po lexoj këtë që po shoh të shkruar këtu.

Do të thirret ministri, zëvendësministri, se janë institucione përgjegjëse; po them përpara se të kalojmë te rektorati, te grupet e interesit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Me iniciativën e grupit të deputetëve të opozitës do të kërkoj ngritjen e një grupi hetimor parlamentar për të hetuar zgjedhjet në Akademinë e Shkencave dhe, më tej, lidhur me projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”, për të gjithë abuzivizmin që po shfaqet në Akademinë e Shkencave, duke filluar që nga fondet, shpërdorimi i tyre, mandatet e mbaruara të sekretarit e të kryetarit, si dhe mënyrës se si u zgjodh Gjinushi, si është dhe si duhet të jetë.

Votimi është bërë me postë. Kanë votuar persona mbi 75 vjeç, persona që sipas statutit dhe sipas ligjit nuk duhej të votonin.

Akademia e Shkencave ka degraduar. Ne paraqesim projektligjin në komision, ndërkohë që zgjedhjet bëhen sipas ligjit të vjetër.

Unë i paraqita propozimet e mia. Mbase kam ardhur vonë në këtë komision, por kërkoj që edhe zëri ynë të dëgjohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Duke qenë se ka pasur dy platforma, ku sipas medias së shkruar dhe të folur, ne të gjithë e dimë se një platformë u shfaq këtu dhe erdhi si iniciativë deputetësh, ndërsa platforma tjetër mbeti e fshehur. Personi që po reagon kaq shumë në media, ky akademik duhet të dëgjohet i vetëm.

Dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA

